S T
# AKT - THEMELIMIT

## TE SHOQERISE ME PERGJEGJSI TE KUFIZUAR

Sot; me daten 12.2.1995, ketu ne Tirane, u paraqiten personal sht subjektet e meposhteme :

Musa Ali Vokshi,lindur me 1950, banues ne Tirane,
Muhamet Ali Vokshi, lindur me 1953, banues ne Tirane
Aleksandra Stefan Prifti, lindur me 1959,banuese ne Tirane
Sulejman Haxhi Vrana, lindur me 1959, banues ne Tirane,
Adrian Adem Vokshi, lindur me 1970, banues ne Tirane
Vasil Stefan Prifti, lindur me 1949,banues ne Tirane
Petraq Lame Gjoka, lindur me 1951, banues ne Tirane
Burhan Taip Beluli, lindur me 1945, banues ne Tirane
Vladimir Ahmet N uro, lindur me 1961, banues ne Tirane
Ferdinand Shahin Fejzo, lindur me 1951,ban es ne Tirane
Shahin Riza Fejzo, lindur me 1923,banues ne Tirane
Fadil Barxhe Haxhiaj, lindur me 1934,banues ne Tirane
Bashkim Ferik Mahmutajlindur me 1950,banues ne Tirane
Klement Panajot Lulo, banues me 1956,banues ne Tirane
Petrit Shyqyri Ymeri, lindur me 1955,banues ne Tirane

NENI 1

Midis subjekteve te mesiperm themelohet nje shoqeri me pergjegjsi te kufizuar e quajtur " EL - ALBA " shpk .

NENI 2

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane , ne rrugen Bajram Curri pall 40,shk 2, ap 14 .

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe.

NENI 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj : transport udhetaresh dhe bagazhesh, ne te gjithe Republiken e Shqiperise dhe jashte saj si dhe cdo aktivitet tjeter qe vecas ose se bashku me ato te permendura me siper do te konsiderohen te pershtatshme ne rritjen e zhvillimin e shoqerise .

NENI 5

Kapitali i shoqerise eshte 500.000 leke ne natyre. Fitimi do te ndahet sipas kontributit te vënë gjate aktivitetit te sejcilit ne natyre ose ne vlerë .

NENI 6

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator.Administrat emerohen Muhamet Ali Vokshi dhe Musa Ali Vokshi, qe te kryejne ne kete akt dhe ne statutin e bashkelidhur te gjitha ndryshimet modifikimet apo te heqin cdo gje qe eventualisht do ti kerkohet ne rastin e rregjistrimit te shoqerise.Palet do te kene nje pjesemarrje ne fitimin e shoqerise ne masen e pjesemarrjes te tyr ne aktivitetin e saj. Palet mbeten gjithashtu pergjegjes per dety met e shoqerise ne kufijte e kapitalit te marre persiper .

NENI 7

Palet kane te drejte te heqin dore nga shoqeria kur kane moti te drejta per kete, pso duke paralajmeruar shoqerine dy muaj perpa ra.

NENI 8

Cdo mosmarreveshje qe mund te lindin midis paleve do te zgjid me mirekuptim dhe ne mungese te saj instance kopetente do te jete Gjykata e Tirane s.

O R T A K E T

| | | |
|---|---|---|
| MUHAMET ALI VOKSHI | MUSA ALI VOKSHI | ALEKSANDRA PRIFTI |
| SULEJMAN VRANA | VASIL PRIFTI | ARDIAN VOKSHI |
| PETRAQ GJOKA | BUXHAN BELULI | VLADIMIR NURO |
| FERDINAND FEJZO | SHAHIN FEJZO | FADIL HAXHIAJ |
| BASHKIM MAHMUTAJ | KLEMENT LULO | PETRIT YMERI |

STATUTI I SHOQËRISË

KREU I

EMËRTIMI, SELIA , KOHË ZGJATJA dhe AKTIVITETI

Neni 1

Shoqëria emërtohet "EL - ALBA" sh.p.k. Ajo është person juri-dik dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, në këtë statut dhe gjithmon në zbatim të Legjislacionit shqiptar.

Nen i 2

Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë në Rrg. " BAJRAM CURRI" pll. 40 , ap. 14 , shk. 2.

Neni 3

Kohë zgjatja e shoqërisë është mbi dhjetë vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

Neni 4

Shoqëria ka për objekt të saj:

- Transportin e udhëtarve e bagazheve në të gjithë teritorin e Republkës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Si dhe çdo aktivitet tjetër që veças ose së bashku me atë të përmëndur më sipër do të konsiderohet e përshtatshme dhe me leverdi për rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë.

KAPITALI THEMELOR

KREU II

NENI 5

Kapitali fillestar i shoqërisë është 500.000lek në natyrë i ndarë në kuota , Fitimi do të ndahet sipas kontributit të dhënë gjatë aktivitetit të sejcilit në natyrë ose në vlerë .

Neni 6

Kuotat e kapitalit mund të shiten midis ortakve, sipas vle-

vlerës së përgjithshme të ralizuar deri në atë moment nga Shoqëria.

Oferta bëhen në përputhje me kuotat e poseduara nga çdo orta dhe ju bëhet e njohur me shkrim ortakve të tjerë që janë të rregjistruar në librin e ortakve duke lënë një kohë maksimale 50 ditë për të vendosur.

Me të skaduar ky afat , ortaku shitës ka të drejtë të shesë kuotën e të tretve gjithmonë me aprovimin paraprak të Asambles së ortakve. N ë çdo rast , ortaku shitës ka të drejtë n ë shoqëri ti nënshtrohet miratimit paraprak të Asambleeë e cila ka një kohë në dispozicion prej 30 ditësh për tu shpreh dhe në rast mospërgjigjje brënda këtij afati , miratimi quhet i dhënë.

Kuotat e kapitalit në rast vdekje i kalohen trashëgimtarve duke hyrë këta të fundit me të gjitha të drejtat e ortakut.

## Neni 7

Shoqëria është pronare e mjeteve të saj.
Ajo ka të drejtë të përdorë e të disponojë mjetet e saj në përputhje me ligjet shqiptare.

## Neni 8

Adresa e ortakve , përsa i përket mardhënjeve të tyre me shoqërinë është ajo e ralizuar në librin e ortakve.

# KREU III

## ASAMBLEA E ORTAKVE

## Neni 9

Asamblea , ligjërisht e thirrur nëpërmjet fax, telfonit, telegramit apo me letër rekomande dhe rregullisht e themeluar përfaqson interesin e ortakve dhe është organi sovran i shoqërisë.
Thirja duhet të bëhet jo më pak se dhjetë ditë përpara asaj të caktuar për mbledhje.

Vendimet e saj të marra konformë ligjit dhe këtij statuti ja të detyrueshme për të gjithë ortakët, përfshi edhe ata në munge apo kundër.

Neni 10

Asamblea është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme.
Ajo mblidhet n ë formën e jashtzakonshme për:
a/ për të b ërë ndryshimet në statutin e shoqërisë.
b/për të ven osur rritjen apo uljen në kapitalin e shoqërisë.
c/për të kaluar në likujdimin e parakohshëm të shoqërisë os për të zgjatur afatin.

Neni 11

Asambletë vendosin në mënyrë të vlefshme me votën pro të shumicës .

Neni 12

Asambletë thirren nga Administratorët duke precizuar në rendin e ditës argumentat që do të trajtohen , në selinë e shoqëri apo në vënd tjetër , ashtu siç do të përmëndet në njoftimin e thirrjes. Asambleja do të jetë rregullisht e mbledhur edhe në mungesë të formaliteteve më lart sa herë që të jetë prezent i tërë kapitali i shoqërisë si dhe organi administrativ i saj.

Neni 13

Asamblea e zakonshme duhet të thirret të paktën njëherë në vit, brënda tre muajv e nga mb yllja e perjudhës ushtrimore . Asamblea e jashtzakonshme mbidhet për vendimet e kopetencës së saj sa herë që organi administtrativ ta quaj të arsyshme.

Neni 14

Kanë të drejtë të marrin pjesë në Asamblen e ortakve vetëm ortakët që figurojnë në librin e ortakve.

Ortakët mund të përfaqsohen nga një ortak tjetër nëpërmje një prokure me shkrim.

Neni 15

Shoqëria Administrohet nga dy Administratorë të vetëm të zgjedhur për herë të parë në Aktin e Themelimit të shoqërisë dhe pas nga Asambleja e ortakve. Administratori i vetëm qëndron në tyrë tre vjet dhe janë të rizgjedhshëm. Administratorët mund emërojnë administrator të deleguar apo të ngarkuar për veprime të ndryshme duke përcaktuar dhe fuqitë e tyre.

Neni 16

E drejta e firmës dhe e përfaqsimit të shoqërisë ju tak vetëm administratorve të ngarkuar.

Neni 17

Për të kontrolluar veprimtarinë ekonomike financjare të shoqërisë , asamblea e ortakve mund të emëroj një këshill rev zorësh të përbërë nga tre antarë duke përcaktuar fuqitë dhe shpërblimin e tyre.

KREU IV

BILANCI I SHOQËRISË

Neni 18

Perjudhat ushtrimore mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo perjudhe ushtrimore Administratorët duhet të përgatisin bilan cin sipas afateve e mënyrës së përcaktuar në ligj i shoqëruar dhe me një relacion mbi ecurinë e shoqërisë.

Neni 19

Fitimi neto që do të rezultoj nga bilanci i shoqërisë do të ndahet sipas mënyrës së më poshtme:

- 5% do të veçohet për tu përdorur si fond rezervë, përdorimi i pjesës tjetër do tu përkasë ortakve , me përjashtim të një vendimi tjetër të Asambles së ortakve.

Ortakët marrin pjesë në ndarjen e fitimit në propocion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë.
Ortakët mbeten përgjegjës për detyrimet e shoqërisë në propocion me kapitalin e marrë përsipër.

## KREU V

## SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 20

Aktiviteti i shoqerise mer fund nga bilancet kontabel rezulto se ajo eshte kontabel apo kur ortaket terhiqen nga shoqeria sipa parashikimit te bere ne aktin e themelimit ose kur mbaron afati i kohes se zgjatjes se shoqerise .

NENI 21

Duke arritur ne shperndarjen e shoqerise,Asambleja e ortakv vendos ne perputhje me ligjin,emerimin e nje ose dy likujdatorve duke percaktuar kopetencat dhe shperblimet .

Neni 22

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis ortakve do te zgjidhe sipas pikes 9 te aktit te themelimit .

NENI 23

Ky a kt u redaktua ne kater kopje duke patur te njejten vlere ligjore .

O R T A K E T

| | | |
|---|---|---|
| Muhamet Vokshi | Musa Vokshi | Aleksandra Prifti |
| Sulejman Vrana | Vasil Prifti | Adrian Vokshi |
| Petraq Gjoka | Burhan Beluli | Vladimir Nuro |
| Ferdinand Fejzo | Shahin Fejzo | Fadil Baxho |
| Bashkim Mahmutaj | Klement. Lulo | Petrit Ymeri |